



SYN.0186

SYNTECH HAG CLEANER

Solucion pastrimi për ndërhyrje të veçanta me rrëshirë hidroreaktive

Kodi doganor

3812 2090

Amballazhimi

- Kanoçe 10 kg

Aplikimi

- Pompë

Familja
Syntech

Tipologjia
Rrëshirë poliuretani hidroekspansive dhe artikuj të ngjashëm

Linjat e produkteve
• Aqua

Kategoritë e përdorimit

- Ndalim i menjëhershëm i depërtimit të ujit me presion në ndërtesa
- Hidroizolim i ambjenteve nëntokësore me produkte hidroekspansive
- Hidroizolim i nyjeve të lëvizjes ose nyjeve të ndërtimit
- Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje për diga, vaska, ujësjellësa dhe kanalizime hidrike
- Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje të tuneleve dhe galerive

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
I lëngshëm

Përshkrimi i produktit

Solucion i posaçëm për pastrimin e pajisjeve që përdoren për injektimet që ndalojnë depërtimin e ujit në ndërtesa. Pastrues me vaj, me toksicitet të ulët dhe me kapacitet të lartë tretës të poliuretanëve jo të ngurtë, përdoret për të pastruar dhe vaisur nga brenda qarqet hidraulike si të pompave manuale, ashtu dhe të atyre elektrike. Ai zëvendëson acetonin, klorur metilin dhe detergjente të tjera që përdoren zakonisht.

Konsumi

Produkti të blihet sipas nevojës.

Fushat e përdorimit

Për pastrimin e pajisjeve që përdoren për injektimin e poliuretanit hidroreaktiv në ndërtime. Pastron poliuretanin e pangurtësuar.

Vetitë kryesore



I pandezshëm



Jetëgjatësia:
12 muaj



Pesha specifike:
1.05 kg/dm³



Të përdoret me doreza mbrojtëse



Të përdoret me syze mbrojtëse



Temperatura e aplikimit:
+10 / +30 °C



Ngjyrat në dispozicion
Trasparente tendente al giallo paglierino

Veçoritë teknike

Flash-Point: ~225 °C

Mënyra e përdorimit

Pasi të keni përfunduar me injektimin e produkteve hidroreaktive me bazë poliuretani, pajisja e pompimit duhet të pastrohet me kujdes. Për ta bërë këtë, së pari duhet të qarkulloni hollues Nitro për disa minuta në qarqet hidraulike të pompës, në mënyrë që të hiqni shpejt mbetjet e poliuretanit të pangurtësuar.

Me të pastruar qarqet e pompës, duhet të qarkullojmë brenda tyre për disa minuta pastruesin vajor SYNTECH HAG CLEANER. Një sasi e vogël e produktit duhet të lihet brenda qarqeve të pompimit, në mënyrë që ato të qëndrojnë të vajasura gjatë periudhës që pompa nuk përdoret. Sasia e parashikuar për përdorim është rreth 2 litra për çdo pompë që do pastrohet gjatë një dite pune.

IF YOU WANT TO SOLVE IT
 azichem

www.azichem.com

Përditësimi më: 25/08/2020
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në www.azichem.it/disclaimer

Magazinimi e Ruajtja

Ruhet nga ngrica. Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarën dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike.



Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose ambalazhit të tij në mjedis.

Përziejëni mirë para përdorimit. Shmangni kontaktin me sytë. Përdorni veshje të përshtatshme për sigurinë, doreza dhe syze mbrojtëse.

SYNTECH HAG CLEANER prodhohet/shpërndahet nga



www.azichem.com

Përditësimi më: **25/08/2020**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398